



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 08

Prishtinë, me 15 .11.2017, në ora:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivkoviç, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Imet Rrahmani, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Xhevahire Izmaku dhe Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë: ministri i Ministrisë së Administratës Publike, z. Mahir Yagcilar dhe Bajram Kosumi, INPO, KDI, Kosovapress, Swok-Kosovo, Epoka e re e dhe Ekonomia online.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit, me këtë

Rend të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 1 dhe 6.11.2017;
3. Raportimi i ministrit të Ministrisë së Administratës Publike, z. Mahir Yagcilar;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 1 dhe 6.11.2017;

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Raportimi i ministrit të Ministrisë së Administratës Publike, z. Mahir Yagcilar;

Nait Hasani, njoftoi komisionin se ministri është ftuar për të raportuar para komisionit për çështjet si në vijim:

Shërbimin civil në Kosovë dhe nivelizimin e pagave, deri ku ka arritur me procedura ministria për plotësim-ndryshimin e Ligjit për shërbimin civil, pastaj rreth reformës në shërbimin civil, sa OJQ janë të regjistruara në Kosovë, a janë të regjistruara konform ligjit në fuqi, a dihet financimi i tyre.

Lidhur me këto pyetje, kryetari ia dha fjalën ministrit.

Mahir Yagcilar, ministër i MAP-së, theksoi se Ministria e Administratës Publike, konform obligimeve të dala nga MSA dhe Raporti i Progresit, vazhdon të angazhohet për përmbushjen e kritereve dhe reformave në fushën e administratës publike, duke avancuar drejt integritimit në BE.

Shërbimi civil në Republikën e Kosovës, sipas legjislacionit të shërbimit civil (Ligji nr. 03/1-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës), është i tërë trupi i personelit administrativ i punësuar në institucionet e administratës qendrore dhe lokale.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të këtyre njësive dhe nëpunësve civilë, Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, përmes Institutit për Administratë Publike, në vazhdimësi ka organizuar trajnime në fushën e politikave dhe procedurave të personelit të shërbimit civil. Në shërbimin civil, gjithashtu janë realizuar vizita në institucionet dhe takime pune për të monitoruar dhe mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil.

Katalogu i vendeve të punës, i cili është miratuar me vendim të Qeverisë, gjatë vitit 2016 dhe 2017, është plotësuar me tituj të rinj të vendeve të punës të standardizuar me vendimin e Qeverisë dhe legjislacionin në fuqi për shërbimin civil. Katalogu përmban tabelën e titujve dhe përshkrimeve të vendeve të punës, përshkrimit të detyrave të punës, me qëllim të rritjes së përgjegjësisë, efikasitetit dhe profesionalizimit në shërbimin civil.

Katalogu i vendeve të punës, gjithashtu mbështet dhe lehtëson zbatimin e sistemit të pagave për nëpunësit civilë dhe mundëson që sistemi i pagave dhe gradave të bëhet në pajtim me parimin “Paga e njëjtë për punë të njëjtë”.

Ligji për pagat e nëpunësve civilë nuk është zbatuar për pjesën e pagave dhe nivelizimi i pagave ende nuk është realizuar, për shkak të kufizimeve financiare, përkundër asaj që MAP ka kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme në aspektin e klasifikimit dhe sistemit teknik për realizimin e sistemit të ri për nivelizimin e pagave në shërbimin civil.

Qëllimi kryesor i katalogut të vendeve të punës është që në kuadër të reformave në shërbimin civil të mbështesë standardizimin e titujve dhe përshkrimin e detyrave të punës, vendosjen e kualifikimeve dhe përvojës së punës për çdo vend të punës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Reformimi i shërbimit civil ka filluar me miratimin e pakos ligjore për shërbimin civil nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2010, e cila përmban: Ligjin për shërbimin civil në Republikën e Kosovës, Ligjin për pagat e nëpunësve civilë dhe Ligjin për administratën shtetërore. Me qëllim të lehtësimin të zbatimit të këtij legjislacioni, Ministria e Administratës Publike, deri në vitin 2012, ka miratuar legjislacionin përkatës sekondar.

Sa i përket regjistrimit të OJQ-ve, sipas evidencës në databazën e Departamentit për Organizata Joqeveritare, prej vitit 1999 deri më datën 7.11.2017, janë regjistruar 9488 OJQ, prej të cilave, aktive janë 9334, 131 të shuara, 23 OJQ të pezulluara. Nga numri i përgjithshëm, vendore janë 8952, ndërkombëtare 531. Për nga forma e organizimit, 860 janë shoqata, ndërsa fondacione 347, të regjistruara nga themelues të komuniteteve jo shqiptare janë, 1206, të regjistruara nga themelues të komuniteteve të ndryshme (shumetnike) 378, me statusin e përfitimit publik janë 237.

Sipas vlerësimeve të MAP-së, Departamentit për Regjistrimin e OJQ-ve, të gjitha OJQ-të janë regjistruara në bazë të ligjit në fuqi. Sa i përket burimeve të financimit, konsiderohen të ligjshme, përderisa nuk është vërtetuar e kundërta, me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente.

Në bazë të Udhëzimit administrativ për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve, 23 OJQ-ve iu është pezulluar veprimtaria, me kërkesë të institucioneve të sigurisë (MPB).

Nait Hasani, pyeti: cilët janë hapat që ministria ka ndërmarrë lidhur me kolizionin e ligjeve, veçanërisht kolizionin e Ligjit të punës me Ligjin për shërbimin civil në Kosovë dhe Ligjin për arsim?

Shqipe Pantina, duke iu referuar Raportit të Progresit për kritikën ndaj administratës publike, si të politizuar, me mangësi profesionale, tha se, në pamundësi për të diskutuar për raportin për shërbimin civil, i cili ishte me tepër kopje e një strategjie, ka sjellë paqartësi rreth synimit për masat që ministria do t'i ketë në legjislaturën aktuale për depolitizimin e administratës publike, ngritjen e llogaridhënies dhe përgjegjësisë.

Ajo pyeti për Projektligjin për pagat, i hartuar në qeverinë e kaluar, i cili ka qenë lajm mediatik. Pse nuk është proceduar në Kuvend zyrtarisht dhe a po zbatohet Ligji për procedurën e përgjithshme administrative dhe Ligji për pagat në fuqi?

Milaim Zeka, pyeti rreth numrit të punësuarave në shërbimin civil, meqë sipas tabelave të vitit 2016, ka mospërputhshmëri në të dhëna. Numri i planifikimeve për punësim është më i lartë nga numri i të punësuarve që nënkupton se në Kosovë nuk ka të interesuar për punësim. Pyeti: kush është përgjegjës për moszbatimin e Ligjit për paga dhe a kanë shkelur OJQ-të statutin në sferën financiare?

Imet Rrahmani, pyeti: a duhet të ndryshohen ligjet për zbatimin e parimit – për punë të njëjtë, pagë të njëjtë dhe a ka filluar ministria realizimin e ndonjë projekti për akomodim të disa institucioneve, meqë ka disa kërkesa në ministri nga institucionet?

Fisnik Ismaili, pyeti: sa e ngarkon buxhetin e Kosovës, rritja e numrit të zëvendësministrave të Qeverisë aktuale, duke ditur që ata kanë vozitës, asistente, vetura e zyra.

Rasim Selmanaj, duke cekur se ka diskrepancë të pagave të nëpunësve civilë, me pozitë të njëjtë, në komuna të ndryshme. Kjo nënkupton që nuk po zbatohet mekanizmi i pagave.

Jasmina Zhivkoviç, pyeti rreth numrit të punësuarve të komunitetit serb në shërbimin civil konform Ligjit për shërbimin civil.

Albert Kinolli, pyeti: cilat kanë qenë sfidat e ministrisë në mandatet e kaluara rreth reformimit të administratës publike?

Valon Ramadani, pyeti: cili është fushëveprimi kryesor dhe në çfarë forme monitorohen nga MAP-ja ato OJQ që kanë statusin e përfituesit publik? Pse portali shtetëror për hapjen e të dhënave është i zbrazët? MAP, sipas vendimit të Qeverisë 07/87, dt. 13 maj 2016, ka qenë e obliguar të përgatisë planin kombëtar të veprimit për hapjen e të dhënave, planin e veprimit për hapjen e të dhënave në baza vjetore dhe menaxhimin e portalit shtetëror të të dhënave. Ai theksoi edhe moszbatimin e memorandumit të lidhur nga MAP për portalin shtetëror. Kjo është mungesë e llogaridhënies, pasi që pronësia e portalit i takon MAP-së.

Mahir Yagcilar, u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të komisionit:

- Ministria e Administratës, në kuadër të kompetencave të saj, ka departamentet që merren me çështjen e nivelizimit të pagave. Ne kemi instaluar sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, në administratë publike janë 18.894 nëpunës civilë.
- Realizimi i pagave nuk zbatohet sipas Ligjit për nivelizimin e pagave, pjesa kryesore, kështu që paga e njëjtë për punën e njëjtë nuk respektohet.
- Çështja e mosprocedimit të Ligjit për pagat në Kuvend, ka pasur arsytet e veta, sepse me të janë zvogëluar për disa kategori pagat, ndërsa për disa kategori janë rritur. MAP, ka përgatitur draftin për nivelizimin, kategorizimin sipas koeficientit, por ka qenë kërkesë e Kuvendit që kjo çështje të shtyhet për procedim.
- Sa i përket kolizionit të ligjeve, është bërë një përpjekje që me akte nënligjore të evitohet kolizioni, domethënë të harmonizojmë ligjet, por megjithatë për disa çështje duhet të ndryshohen ligjet, me aprovimin e Ligjit për shërbimin civil, do të përcaktohet se cili ligj është bazik.
- Sa i përket planifikimit të punësuarve, mospërputhshmërisë në të dhëna sipas tabelave, kjo qëndron, sepse ka pensionime, pezullime të pozitive, shuarje të pozitës etj., numri nuk është gjithnjë i saktë.
- Kritikat e BE-së janë për të gjithë, jo vetëm për administratën publike. Edhe BE ka pasur kërkesë për tërheqjen e Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë, me qëllimin që tri projektligjet të procedohen në Kuvend, në pako.
- Ligji për procedurën administrative është reformë dhe reformat në fillim janë të vështira, megjithatë ligji është i standardizuar me ligjet e vendeve të tjera.
- Sa i përket rritjes së numrit të zëvendësministrave, kjo është çështje e Qeverisë, si tërësi, ndërsa sa i përket stafit të tyre, veturave, zyrave, është vështirë të akomodohen në mungesë të hapësirave.

4. Të ndryshme

Nait Hasani, propozoi që për hartimin e draft-ligjit për RTK-në, të merret model ligji i transmetuesit publik të Sllovenisë. Gjithashtu, për hartimin e draftit, komisioni të organizojë mbajtjen e një tryeze brenda në Kosovë dhe tjetrën jashtë Kosovës.

Konstatim: Komisioni votoi unanimitisht për propozimet e lartcekura.

Kryetari i komisionit, gjithashtu, njoftoi komisionin për një propozim të KDI-së, mbi bazën e memorandumit të bashkëpunimit që ata kanë me Kuvendin e Kosovës, për të bërë hulumtim lidhur me zbatimin e ligjeve për shërbyesit civilë.

Shqipe Pantina, propozoi që të hulumtohet edhe zbatimi i Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Konstatim: Komisioni votoi unanimitisht edhe për propozimin e dytë.

Mbledhja përfundoi në orën:11:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani